

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)**Buletini Nr. 28 / 2025, 28-01-2025****Parashikimi** nga 28-01-2025, ora 12:00 deri 29-01-2025, ora 23:59.**PARASHIKIMI METEO****RESHJET**

Sot pasdite (e martë dt. 28) dhe nesër (e mërkurë dt. 29) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Gjirokastrë, ndërsa në qarqet e tjera priten reshje mesatare. Reshjet pritet të shoqërohen me shtrëngata në të gjitha qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Nesër (e mërkurë dt. 29) në zonat malore në Veri dhe Verilindje në lartësitë mbi 900m nga niveli i detit reshjet priten në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve për momente të shkurtra mund të krijojnë probleme të ndryshme si dhe vërshime të ujit në zonat urbane në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Vlorë dhe Gjirokastrë.

**TEMPERATURA**

Nesër (e mërkurë dt. 29) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 11 / 15 °C

në vendet e ulëta: 8 / 16 °C

në vendet malore: 3 / 13 °C

**ERA**

Sot pasdite (e martë dt. 28) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë, ndërsa nesër (e mërkurë dt. 29) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

**NIVELET E RREZIKUT****S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: *Gentiana Stafa*Koordinator: *Elona Abazi* ( Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 1 / 3

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)













Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 28 / 2025, 28-01-2025

Parashikimi nga 28-01-2025, ora 12:00 deri 29-01-2025, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare					
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare					
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT**  
**për sot dhe nesër, dt. 28 - 29**

**SIMBOLE**

	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke